

GJYKATA EVROPIANE PËR TË DREJTAT E NJERIUT

SEKSIONI I TRETË

VENDIM

Kërkesa nr. 52062/16

Enver RRAPAJ

kundër Shqipërisë

(shih tabelën bashkëlidhur)

Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut (Seksioni i Tretë), e mbledhur më 31 gusht 2023, si një Komitet i përbërë nga:

Ioannis Ktistakis, *kryetar,*

Darian Pavli,

Oddný Mjöll Arnardóttir, *gjyqtarë*

dhe Viktoriya Maradudina, *zëvendëssekretare e përkohshme e Seksionit,*

Duke mbajtur në konsideratë kërkesën e mësipërme të depozituar më 18 gusht 2016,

Duke mbajtur në konsideratë deklaratën e paraqitur nga Qeveria e paditur sipas së cilës Gjykatës i kërkohej të përjashtonte kërkesën nga lista e çështjeve,

Pasi diskutoi, vendosi si më poshtë:

FAKTET DHE PROCEDURA

Detajet e kërkesit janë paraqitur në tabelën bashkëlidhur.

Kërkuesi u përfaqësua nga z. D. Kruja, një avokat që e ushtron profesionin në Tiranë.

Qeverisë Shqiptare (“Qeveria”) iu komunikuan ankesat e kërkesit bërë në mbështetje të nenit 6 § 1 të Konventës në lidhje me kohëzgjatjen e tepërt të procesit gjyqësor dhe mungesën e së drejtës për t’iu drejtuar gjykatës si rezultat i kohëzgjatjes së tepërt të procesit gjyqësor.

LIGJI

Pas negociatave të pasuksesshme për zgjidhje miqësore, Qeveria informoi Gjykatën se Qeveria propozonte lëshimin e një deklarate të njëanshme me qëllim zgjidhjen e çështjeve të ngritura me anë të këtyre ankesave. Gjithashtu, Qeveria i kërkoj Gjykatës që të përjashtonte kërkesën në mbështetje të nenit 37 të Konventës.

Qeveria pranonte shkeljen e nenit 6 § 1 të Konventës. Ajo ofronte që t’i paguante kërkesit shumën e detajuar në tabelën bashkëlidhur dhe e ftonte Gjykatën ta përjashtonte kërkesën nga lista e çështjeve në mbështetje me nenit 37 § 1 (c) të Konventës. Shuma do të konvertohej në monedhën e Shtetit të paditur dhe do të shlyhej brenda tre muajve nga data e njoftimit të vendimit të Gjykatës. Nëse kjo shumë nuk do të shlyhej brenda periudhës tremujore të sipërpërmendur, Qeveria merrte përsipër të paguante interesin e thjeshtë për këtë shumë, që nga përfundimi i periudhës deri në shlyerje, në normën e barasvlershme me normën marginale të huadhënies plus tri pikë përqindje.

Pagesa do të përbënte zgjidhjen përfundimtare të çështjes.

Disa javë përpara këtij vendimi, kërkesit iu dërguan kushtet e deklaratës së njëanshme të Qeverisë. Gjykata nuk ka marrë një përgjigje nga kërkesi për pranimin e kushteve të shprehura në deklaratë.

Gjykata konstaton se neni 37 § 1 (c) i krijon mundësinë të përjashtojë çështjen nga lista e saj, nëse:

“për çdo arsye tjetër që, sipas Gjykatës, nuk justifikon vazhdimin e shqyrtimit të kërkesës.”.

Në këtë mënyrë, ajo mund t'i përjashtojë kërkesat nga lista e saj e çështjeve në mbështetje të nenit 37 § 1 (c) sipas një deklarate të njëanshme bërë nga Qeveria përgjegjëse edhe nëse kërkuksi dëshiron që të vazhdojë shqyrtimi i çështjes (shih, veçanërisht, vendimin *Tabsin Acar kundër Turqisë* (kundërshtimet paraprake) [DHM], nr. 26307/95, §§ 75–77, GJEDNJ 2003-VI).

Gjykata ka ndërtuar një praktikë gjyqësore të qartë dhe të gjerë në lidhje me ankesat që kanë të bëjnë me kohëzgjatjen e tepërt të procesit gjyqësor civil (shih, për shembull, *Luli dhe të tjerët kundër Shqipërisë*, nr. 64480/09 dhe 5 të tjerë, 1 prill 2014, dhe *Mishgjonit kundër Shqipërisë*, nr. 18381/05, 7 dhjetor 2010).

Në mungesë të argumenteve kundërshtuese nga kërkuksi, Gjykata nuk ka arsye të mendojë se kompensimi i ofruar nga Qeveria përbën një zgjidhje të papërshtatshme ose të paarsyeshme për shkeljen e të drejtave të tij sipas Konventës (shih *Ryabkin dhe Volokitin kundër Rusisë* (vendim), nr. 52166/08 dhe 8526/09, §§ 49–50, 28 qershor 2016, dhe *Igranov dhe të tjerë kundër Rusisë*, nr. 42399/13 dhe 8 të tjerë, § 24, 20 mars 2018, dhe për një qasje të ngjashme, *Antovski dhe të tjerë kundër Maqedonisë së Veriut* (vendim), [Komiteti], nr. 68160/17, 8 dhjetor).

Duke theksuar parashtrimet në deklaratën e Qeverisë si edhe shumën e kompensimit të propozuar – e cila përkon me shumën e akorduar në çështje të ngjashme – Gjykata gjykon se nuk justifikohet që ajo të vijojë me shqyrtimin e mëtejshëm të kërkesës (neni 37 § 1 (c)).

Mbështetur në sa më sipër, Gjykata gjykon se për sa i përket të drejtave të njeriut sipas parashikimit të Konventës dhe protokolleve të saj, Gjykatës nuk i kërkohet që të vijojë shqyrtimin e kërkesës (neni 37 § 1 *in fine*).

Së fundmi, Gjykata thekson se nëse Qeveria nuk respekton kushtet në deklaratën e saj të njëanshme, kërkesa mund të rikthehet në listën e çështjeve në mbështetje me nenin 37 § 2 të Konventës (shih *Josipović kundër Serbisë* (vendim), nr. 18369/07, 4 mars 2008).

Sipas sa më sipër, është e drejtë që çështja të përjashtohet nga lista.

Për këto arsye, Gjykata, në mënyrë unanime,

Mban në konsideratë kushtet në deklaratën e Qeverisë së paditur dhe angazhimet për të garantuar respektimin e premtimeve të bëra në të;

Vendos të përjashtojë kërkesën nga lista e saj e çështjeve në përputhje me nenin 37 § 1 të Konventës.

Hartuar në anglisht dhe njoftuar me shkrim më 21 shtator 2023.

Viktoriya Maradudina

Zëvendëssekretare e përkohshme e Seksionit

Ioannis Ktistakis

Kryetar

SHTOJÇË

*Kërkesa sipas së cilës paraqiten ankesa në mbështetje të nenit 6 § 1 të Konventës
(kohëzgjatje e tepërt e procesit gjyqësor civil)*

Ankesa nr. Data e paraqitjes	Emri i ankuesit Viti i lindjes	Emri dhe vendndodhja e përfaqësuesit	Data e marrjes së deklaratës së Qeverisë	Shuma e akorduar për dëmin jopasuror dhe kostot dhe shpenzimet për kërkuks sipas deklaratës së njëanshme (në euro) ¹
52062/16 18.8.2016	Enver RRAPAJ 1962	Kruja Dritan Tirana	5.10.2021	4,000

¹ Plus çdo taksë që mund t'i tarifohet kërkuksit.